



Pranuar / Dorezuar Punijeno/Prodato Recieved/Delivary	18.05.2022	viti god year	2
Organ /Njësia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDMSH-CK	2903/2022		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr. 329/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës –Kolegji për shqyrtimin e ankesave nga: Eshref Shabani, kryetar, Malsore Gashi – Bajraktari dhe Jeton Koca anëtarë, me Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.329 /2022 të datës 05.04.2022 të parashtruar nga ankuesja

me adresë banimi rruga nga Komuna e Lipjanit, kundër organit të punësimit Shërbimi Korrektues i Kosovës, në çështjen juridike “ masë disiplinore”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 17.05.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr. 329/2022 e datës 05.04.2022 e parashtruar nga ankuesja

II. Shfuqizohet Vendimi me numër K.D.nr.004/2022 i datës 11.03.2022 i Komisionit Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës.

III. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm dhe Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të tij, duke bërë shuarjen e masës disiplinore ndaj ankuesit në pajtim me këtë vendim dhe dispozitat ligjore në fuqi, si dhe kompensimin e pagës në vlerën 20% për një muaj të ndaluar sipas vendimit si në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ndaj ankuesja në bazë të shkesave të lëndës, është e punësuar në pozitën Mbikëqyrëse në Qendrën Korrektuese në Lipjan, më datë përmes amilit të datës 04.02.2022 është bërë kërkesë për inicimin e procedurës disiplinore me arsyetim që në Qendrën Korrektues për Femra në Lipjan janë montuar disa kamera për vëzhgim të rasteve psikiatrike.

Fillimisht më datë 02.03.2022 Komisioni i Brendshëm Hetimor i Shërbimit Korrektues të Kosovës, ka hetuar këtë rast dhe ka dhënë disa rekomandime. Bazuar në këtë raport, Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës, më datë 11.03.2022 ka nxjerr Vendim KD.nr.004/202 me të cilin ankueses i ka shqiptuar masën disiplinore *"ndalim 20% të pagës për periudhën një muaj"*.

Ankuesja kundër Vendimi K.D nr.004/2022 të datës 11.03.2022 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, me datë 05.04.2022, me numër protokolli 1858/2022, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 14.04.2022, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Shërbimit Korrektues i Kosovës, Ndërsa me datë 14.04.2022, Këshilli ka pranuar përgjigjen ne ankesë të ankuesit si dhe shkresat lidhur me lëndën.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritator ka administruar këto prova: Ankesën e datës 05.04.2022, e parashtruar nga ankuesja me numër protokolli 2245/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi me numër K.D.nr.004/2022 i datës 11.03.2022 i Komisionit Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës; Raporti i Hetimit i datës 02.03.2022, i Shërbimit Korrektues të Kosovës; e- maili i datës 24.02.2022; Urdhëresë e datës 18.01.2022; e- miali i datës 25.01.2022; e- maili i datës 04.02.2022, i zëvendës drejtoreshës; raporti i datës 04.02.2022, i gjendjes shëndetësorë të paraburgosurave; ; raporti i datës 21.01.2022, i gjendjes shëndetësorë të paraburgosurave; raporti i datës 18.01.2022, i gjendjes shëndetësorë të paraburgosurave; raporti i incidenti i datës 18.06.2021; raporti i incidenti i datës 10.09.2021; urdhëresë e datës 26.01.2022; Vendimi i datës 04.03.2022;Vendimi i datës 04.03.2022; kontrata e punës e datës 01.07.2018; Përshkrimi i detyrave të punës; Raporti i datës 24.02.2022, i Avokatit të Popullit; Ftesë për intervistë e datës 16.02.2022; Emailin e datës 04.02.2022 dhe 16.05.2022 Përgjigje në ankesë e datës 20.04.2022, me numër protokolli 2245/2022;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses,
është e bazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke u bazuar në të gjitha dëshmitë e lëndës, konstaton se procedura disiplinore ndaj ankuseses është iniciuar më datë 04.02.2022 përmes emailit e cila i është përcjell anëtarëve të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, ndërsa rasti nga Komisioni Disiplinor është vendosur vetëm pas Raportit të datës 02.03.2022 të Komisionit të Brendshëm Hetimor i Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Bazuar në nenin 135 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, është përcaktuar që: *"Përpos kur ligji parasheh një afat të ndryshëm, akti administrativ që zgjidh ankesën do të nxirret dhe njoftohet palës brenda tridhjetë (30) ditëve nga parashtrimi i ankesës"*, ndërsa neni 12 paragrafi 6 i Rregullores (QRK) nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, përcakton se: *"Komisioni disiplinor duhet të marrë vendim brenda 30 ditëve pas pranimit të kërkesës për inicim të procedurës nga njësia për burime njerëzore"*, mirëpo meqë rastin është pranuar direkt nga anëtarët e Komisionit Disiplinor, atëherë komisioni është dashur që të vendos brenda këtij afati, por sipas Kolegjit për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, meqenëse Raportit të datës 02.03.2022 të Komisionit të Brendshëm Hetimor i Shërbimit Korrektues të Kosovës ka qenë si parakusht për vendimmarrje për këtë rast, atëherë sipas normave në fuqi, Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës është dashur që të bëjë shtyrjen e afatit për vendosje në pajtim me nenin 135 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, është përcaktuar që: *"Afati i paraparë nga paragrafi 1 i këtij neni, mund të shtyhet kur nevojiten shqyrtime administrative shitesë. Neni 99 i këtij Ligji do të zbatohet përshtatshmërisht gjithashtu për shtyrjen e afatit të paraparë sipas paragrafit 1 të këtij neni"*, ndërlidhur me këtë nenin 99 paragrafi 1 dhe 2 i Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, është përcaktuar që: *"Përveç kur ndalohet shprehimisht me ligji, nëse është e nevojshme për shkak të kompleksitetit të çështjes administrative konkrete, organi publik mund të shtyjë, vetëm një herë, afatin fillestar të paraparë për përfundimin e procedurës administrative, sipas nenit 98 të këtij Ligji. 2. Shtyrja sipas paragrafit 1 të këtij neni, do të bëhet për aq kohë sa është e nevojshme për të përfunduar procedurën administrative dhe duhet të jetë në përpjestim me kompleksitetin e çështjes konkrete, por nuk mund të jetë më e gjatë se afati fillestar"*.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, meqenëse në prova të lëndës nuk ka asnjë dëshmi që Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës, nuk ka nxjerr asnjë vendim për shtyrje të afatit për vendosje, atëherë Vendimi me numër K.D.nr.004/2022 i datës 11.03.2022 i Komisionit Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës konsiderohet që është nxjerr jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 12 paragrafi 6 të Rregullores (QRK) nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, si rrjedhojë Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, se Vendimi me numër K.D.nr.004/2022 i datës 11.03.2022 i Komisionit Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës është i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafin, 1.3 dhe 1.5, të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.



Si u tha më lartë, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se obligohet Drejtori i Përgjithshëm dhe Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore i Shërbimit Korrektues të Kosovës, që në pajtim me dispozitivin e këtij vendimi të bëjë kompensimin e ndalesës "ndalim i 20% i pagës për periudhën një muaj" dhe të bëjnë shuarjen e masës disiplinore ndaj ankuesit në pajtim me këtë vendim.

Meqenëse nga të lartcekurat është konstatuar që gjatë zhvillimit të kësaj procedure disiplinore, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka gjetur që ka pasur shkelje procedurale, atëherë në këtë rast nuk është lëshuar në pretendimet për shkelje të supozuara nga ana e ankueses.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmer veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyres për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr. 329/2022

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

Ankueses

Drejtorit të Shërbimit Korrektues të Kosovës;

Udhëheqësit të Personelit në Shërbimin Korrektues të Kosovës;

Arkivit të KPMSHCK-së;